



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 25.06.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Elisa Spiropali – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 18 dhe 19 qershor 2018.
2. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar””.
(Komision për dhënie mendimi)

Marrin pjesë:

Elisa Spiropali, Bardh Spahia, Klodiana Spahiu, Ilir Pendavinji, Flamur Golemi, Edlira Bode, Adelina Rista, Arben Kamami, Roland Xhelilaj, Almira Xhembulla, Nuri Belba, Floida Kërpaçi, Grida Shqina, Halim Kosova, Orjola Pampuri, Lindita Metaliaj.

Mungojnë:

Petrit Vasili dhe Vangjel Tavo.

Të ftuar:

Ardiana Jaku – Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Merita Xhafaj – Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Brunilda Dervishaj – Specialiste në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Etleva Sheshi – Përgjegjëse Sektori në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

HAPET MBLEDHJA

Elisa Spiropali – Përsëritje të gjithëve!

Sot Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë do ta zhvillojë mbledhjen me këtë rend dite: së pari, miratimi i procesverbaleve të datave 18 dhe 19 qershor. A ka objeksione ose sugjerime?

Atëherë, miratohen siç kanë ardhur.

Pikë e dytë e rendit të ditës është shqyrtimi nën për nën i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar””.

Ky është komision për dhënie mendimi. Komision përgjegjës është Komisioni i Ligjeve. Në këtë mbledhje marrin pjesë: Ardiana Jaku, zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Merita Xhafaj, drejtoreshë e Përgjithshme, Brunilda Dervishaj, specialiste dhe Etleva Sheshi, përgjegjëse sektori. Besoj se janë të katra zonjat.

Pa humbur kohë, kalojmë në shqyrtimin nën për nën të projektligjit. Po lexoj nënin e para, pastaj ndryshimet. Në vazhdim do të lexoj vetëm ndryshimet që janë sjellë për miratim.

Bardh Spahia – Zonja kryetare, për procedurë, të lutem!

Elisa Spiropali – Po, për procedurë!

Bardh Spahia – Të nderuar pjesëmarrës, dëshiroj ta nis fjalën time ose diskutimin tim në këtë komision sot, duke sjellë në vëmendjen e medieve dhe mbarë opinionit publik të një akti skandaloz që ndodhi në seancën e fundit të parlamentit, siç ishte...

Elisa Spiropali – Zoti Spahia, ju dhashë fjalën për procedurë, ju lutem! Kjo nuk ka lidhje me procedurën.

Bardh Spahia – Ka lidhje me procedurën...

Elisa Spiropali – Mos e prishni edhe këtë komision, siç keni prishur mbledhjet e komisioneve të tjera, se është komision i rëndësishëm...

Bardh Spahia – Heqja e të drejtës së fjalës së opozitës ishte një akt i paprecedent dhe thellësisht antikushtetues. Kjo sjellje, e denjë vetëm për një Kryetar Kuvendi i cili ishte pjesë aktive e nomenklaturës së kuqe dhe e kësaj maxhorance të zhytur në krim dhe në drogë, e mësuar të ketë në gjirin e saj kriminelë dhe injorantë, nuk e zvogëlon aspak opozitën, përkundrazi sjell akoma më

shumë në pah nevojën emergjente, nevojën urgjente për ta ndaluar rrokullisjen e vendit drejt një neodiktature....

Elisa Spiropali – Keni foltoret e konferencave të shtypit.

Bardh Spahia – ..për të frenuar nevojën emergjente...

(Reagime pa mikrofon)

Elisa Spiropali – Jo, tani ka përgatitur 4 faqe për procedurë të përgatitura paraprakisht! Jo, kjo nuk ka kuptim. I keni prishur të gjitha mbledhjet.

Bardh Spahia – Nxjerr edhe një herë në pah nevojën urgjente për ta frenuar rrokullisjen e vendit drejt një neodiktature...

Elisa Spiropali – Nuk të dëgjon njeri. E keni përsëritur me mijëra herë këtë. Ju lutem, është recitim banal. Mos na e prishni mbledhjen e komisionit!

Bardh Spahia – Kjo që ndodhi në seancën e fundit parlamentare dhe sjellja e kësaj maxhorance, e kësaj qeverie, duhet të jetë një kampion alarmi për çdo qytetar të lirë të këtij vendi.

Elisa Spiropali – Edhe një herë, ju informoj se kjo nuk ka asnjë lidhje me procedurën, është një recitim që ju e bëni kudo, në çdo komision. Ju lutem, mos na e prishni këtë komision!

Bardh Spahia – Nuk është një recitim, është një referim i ngjarjeve dhe i sjelljes në seancën e fundit parlamentare nga ana e kësaj maxhorance.

Elisa Spiropali – Ju lutem! Tani po flasim për dhunën në familje! Jini seriozë dhe flisni për projektligjin! Ju lutem!

Bardh Spahia – Një sekondë, se do të dal edhe aty...

Elisa Spiropali – Tani të lutem!

Bardh Spahia – Ka më shumë se dy muaj që kjo maxhorancë, e kapur dhe e zhytur totalisht, mundohet me të gjitha format dhe mënyrat të japë idenë se këtu në këtë vend çdo gjë funksionon normalisht dhe mundohet ta bëjë këtë duke përdorur të gjithë arsenalin e vet të veglave dhe të shërbëtorëve të këtij pushteti të kalbur që po shembet, po shkërmoqet çdo ditë nën peshën e zullumeve të saj të panumërta. Sot jo vetëm elektorati...

Elisa Spiropali – Po kemi një ligj të rëndësishëm sot, more zoti Bardhi!

Bardh Spahia – Të lutem, unë kam një detyrim ndaj zgjedhësve tanë...

Elisa Spiropali – Kemi një ligj për masat kundër dhunës në familje. Tani, jeni për të diskutuar për këtë, apo jo?

Bardh Spahia – Do të dal edhe të ligji.

Elisa Spiropali – Po diskutoni për projektligjin.

Bardh Spahia – Më dëgjo me vëmendje, se do të dal edhe aty.

Elisa Spiropali – Keni foltoren e SHQUP-it për këtë punë.

Bardh Spahia – Sot jo vetëm elektorati që unë përfaqësoj.

Elisa Spiropali – Nuk mund të abuzoni me të drejtën e fjalës.

Bardh Spahia – Elisa, dëgjo, se do të dal edhe aty!

Elisa Spiropali – Jo, Bardhi!

(Reagime pa mikrofon)

Jo, mbaroi fjala, nuk kishte për procedurë. Kaq ishte.

Bardh Spahia – Sot jo vetëm elektorati që unë përfaqësoj, por besoj se çdo qytetar i ndershëm i këtij vendi, që nuk është i lidhur me krimin apo me pushtetin tuaj të inkriminuar, kërkon të dijë se çfarë po ndodh me një ngjarje të rëndësishme, siç është ajo e procesit për hapjen e negociatave. Gjermania dhe Franca menjëherë pas samitit të përbashkët u shprehën se qeveria shqiptare nuk i ka plotësuar kushtet, nuk i ka kryer detyrat e shtëpisë.

Elisa Spiropali – Është komision tjetër ai, zoti Spahiu.

Bardh Spahiu – Jo vetëm lanë në fuqi ato kushte, por madje u shtuan atyre kushteve që kishin vënë edhe nevojën...

Elisa Spiropali – Është komision tjetër. Kur të shkoni të prishni Komisionin e Integritetit, mund të lexoni këtë deklaratë. Ndryshoni kasetë; kasetë tjetër...

Bardh Spahia – ...immediate, të jashtëzakonshme për të monitoruara referencat dhe raportet e qeverisë shqiptare. Ky është një lajm tejet i trishtuar për Shqipërinë dhe shqiptarët, të cilët vazhdojnë të mbahen peng nga një qeveri, e cila është këmbë e krye e kontrolluar dhe e lidhur me krimin. Nuk ka integritet për Shqipërinë derisa të vendosen përpara drejtësisë politikanët e inkriminuar, të lidhur me krimin dhe të korruptuar.

Elisa Spiropali – Ju lutem, po dhunoni këtë komision në mënyrën më të papërgjegjshme të mundshme! Ju lutem, mbylljani fjalën zotit Spahia, sepse kjo nuk ishte për procedurë!

Bardh Spahia - Nuk ka integritet për shqiptarët pa luftuar trafikun dhe kultivimin e drogës, i cili lulëzon sot në Shqipëri, me mbështetjen e kësaj qeverie dhe kësaj maxhorance.

Elisa Spiropali – Kur të kemi diskutimet flisni sërish.

Bardh Spahia - Nuk ka integritet të Shqipërisë dhe të shqiptarëve pa një reformë zgjedhore, e cila të garantojë zgjedhje të ndershme...

Elisa Spiropali – Zoti Spahia, kaq ishte fjala juaj, ju lutem, mbylleni mikrofonin!

Bardh Spahia –...pa përdorimin e parave të drogës për të ndikuar direkt në rezultatin e zgjedhjeve.

Elisa Spiropali – Ju lutem, kalojmë nen për nen në projektligjin “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

Bardh Spahia - Nuk ka integrim pa një reformë të vërtetë në drejtësi, e cila....

Elisa Spiropali – Nuk ju dëgjon njeri, sepse e dinë se çfarë doni të thoni.

Bardh Spahia – ...e cila të mos mbrojë Saimir Tahirin, Fatmir Xhafajn apo Agron Xhafajn...

Elisa Spiropali – Keni Komisionin e Integritetit.

Bardh Spahia – ...të mos mbrojë Edi Ramën dhe Olsi Ramën, por të luftojë, me të gjitha forcat, krimin dhe kriminelët, trafiket dhe korrupsionin.

Sigurisht, nuk mund të ketë integrim kur Ministria e Brendshme, ministria më e rëndësishme e qeverisë suaj, kalon nga një grup kriminal trafikantësh....

Elisa Spiropali – 5 minuta pushim dhe e vazhdojmë sërish mbledhjen për nenet. Në rregull?

Bardh Spahia –...në një grup tjetër trafikantësh. Nuk mund të ketë integrim kur dy ministra Rendi, njëri pas tjetrit, zihen dhe bërtasin...

(Ndërpritet mbledhja)

Elisa Spiropali – Jemi gati?

Rifillojmë mbledhjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bardh Spahia - Aty ku e lamë.

Elisa Spiropali - Është fatkeqësi që opozita e vendit vjen në Komisionin e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë për të diskutuar për masat për dhunën në marrëdhëniet familjare dhe dhunon vendin tonë të punës së përbashkët, komisionet parlamentare, seancën dhe dhunon hapësirën publike shqiptare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bardh Spahia - Do t’ju flas edhe për dhunën, edhe për modelin e kësaj maxhorance.

Elisa Spiropali - Të lutem, mbylle mikrofonin, sepse po flas unë! Kur ta keni fjalën ju, atëherë diskutoni!

Bardh Spahia – E kisha fjalën unë dhe m'u ndërpre.

Elisa Spiropali - Jo, ju mbaruat.

Unë jam drejtuesja e këtij komisioni, fikni mikrofonin! Kur t'ju vijë radha pastaj keni të drejtë të flisni.

Bardh Spahia – Të lutem!

Fjalën nuk mund të ma ndërpresë asnjëri.

Elisa Spiropali - Është fatkeqësi, sepse ky është një projektligj shumë i rëndësishëm për të mbrojtur gatë shqiptare nga dhuna.

Bardh Spahia –Të dashur qytetarë shqiptarë që po na ndiqni...

Elisa Spiropali – Në rast se ligjvënësit shqiptarë nuk kanë as minimumin e përgjegjshmërisë...

Bardh Spahia- Siç e thashë edhe pak më parë, nuk ka integrim derisa të vendosen para drejtësisë të gjithë politikanët e korruptuar të lidhur me krimin...

Elisa Spiropali- Të lutem, fike mikrofonin që të vazhdojmë mbledhjen!

Po, duke nisur nga kryetari juaj i pari.

A mund ta mbyllësh, të lutem?

Bardh Spahia ...pa luftuar trafikun e drogës dhe kultivimin e saj, si edhe lidhjen, mbështetjen e këtij trafiku nga qeveritarët, ministrat dhe pushtetarët e sotëm.

Elisa Spiropali- Në nenin 1 bëhen...

Ju lutem, mos bëni zhurmuesin në mbledhjen e komisionit!

Mos bëni zhurmuesin, sepse është turp!

Bardh Spahia - Nuk ka integrim pa një reformë zgjedhore, e cila të garantojë zgjedhje të lira dhe të ndershme...

Elisa Spiropali- Përsëri do t'i humbni, kot e keni. Do të bëhet edhe reforma, por përsëri do t'i humbini zgjedhjet me këtë sjellje.

Bardh Spahia -...larg influencës së parave të pista të drogës, mbështetëse e fuqishme e qeverisë dhe e pushtetarëve të sotëm.

Elisa Spiropali – Bravo të qoftë! A mbarove?

Bardh Spahia - Nuk mund të ketë integrim pa një reformë reale në drejtësi, të vërtetë, e cila ...

Elisa Spiropali - Zoti Spahia po bëheni qesharak në sy të publikut!

Bardh Spahia...të mos mbrojnë ish- ministrin e Brendshëm Tahiri apo ministrin aktual të Brendshëm Xhafajn, vëllain e tij, kushërinjtë e atij tjetrit...

Elisa Spiropali – Nuk e merrni dot peng këtë komision, as parlamentin shqiptar, as integrimin e vendit dhe as të ardhmen tonë.

Bardh Spahia -... Kryeministrin aktual dhe vëllanë e tij dhe çdo pushtetar, ministër qeveritar, kushdo qoftë, por do të jemi në luftë ballore kundër krimit dhe korrupsionit.

Elisa Spiropali – Bravo të qoftë!

Tani vazhdojmë!

Bardh Spahia- Të dashur kolegë të maxhorancës, këto juve nuk ju pëlqejnë, sepse pa këto ju nuk keni frymë, pa këto ju nuk keni jetë. Patët edhe rastin e fundit që ta vërtetonit, me kapjen e asaj “*Toyota Yaris*” të famshme, që u deklarua nga kryetari i opozitës në seancën e kaluar në parlament dhe me të cilën qeshët të gjithë juve dhe më shumë se të gjithë qeshi pronari i vërtetë i parave të asaj “*Toyota Yaris*”.

Elisa Spiropali- Shko dhe dëshmo në prokurori!

Bardh Spahia- Qeshi kryetari i grupit tuaj parlamentar zoti Balla, i cili u mundua ta fshehtë atë fakt me një zgërdhimje.

Elisa Spiropali – Siç duhet të dëshmojnë kolegët për “Babalen”.

Bardh Spahia - Por sigurisht që sot duhet të jetë ridimensionuar, sepse iu faktua përfshirja e tij në atë sasi parash tek ajo *Toyota Yaris*.

Elisa Spiropali - Jeni bërë një “Babale” parti, një “Babale” grup me një “Babale” lider! A ka mundësi, të vazhdojmë mbledhjen?

Bardh Spahia- Të dashur kolegë,

Të dashur qytetarë shqiptarë, ne sot...

Elisa Spiropali- Nuk po të dëgjojnë as të tutë.

Bardh Spahia... do të duhej të diskutonim, në fakt për dhunën në familje.

Elisa Spiropali- E the një herë këtë, ngatërrove faqen!

Bardh Spahia - ...për disa ndryshime në projektligjin...

Elisa Spiropali - Ja të flasë doktor Halimi.

Bardh Spahia -...për dhunën në marrëdhëniet familjare dhe nuk mund të lë pa përmendur se një ndër shkaktarët kryesorë, në mos shkaktori kryesor i shtimit në mënyrë të jashtëzakonshme të rasteve të dhunës në familje është pikërisht kjo qeveri, janë politikat e kësaj

qeverie, politikat repersive të kësaj qeverie, e cila pasi varfëroi në ekstrem, pasi rriti papunësinë, pasi rriti kriminalitetin, pasi u vrau shpresën qytetarëve shqiptarë u vuri lakun në fyt me taksat, gjobat, aq sa i detyroi me dhjetëra prej tyre të shkonin drejt akteve ekstreme, siç janë rastet e pafundme të vetëvrasjeve...

Elisa Spiropali - Nuk po të dëgjojnë as të tutë, po dërgojnë mesazhe. A ka mundësi, ta...

Bardh Spahia- ... dhe të krimeve të shumta me një numër jashtëzakonisht të madh të krimit në familje. Çfarë do t'u themi ne qytetarëve shqiptarë për dhunën në familje, kur shqiptarët kanë për shembull një kryeministër, i cili është simbol i një personi që ka ushtruar dhe vazhdon të ushtrojë dhunë, jo vetëm në familjen e tij, por në familjen e çdo qytetari shqiptar?

Çfarë mund të diskutojmë sot, kur të gjithë shqiptarët e dëgjojnë me veshët e tyre Kryeministrin teksa shprehet me vulgaritet, me fjalë ofenduese, fyese, ekstreme ndaj një qytetari të thjeshtë, ndaj një djali të ri, i cili në mënyrë shumë të moderuar i drejtohet me një shqetësim të madh “Çfarë po bëni për vendin tuaj?”. Kjo pasohet me breshërinë e fyerjeve, ofendimeve ekstreme nga Kryeministri...

Elisa Spiropali – Po ju lutem, doktor, mbylleni mikrofonin!

Bardh Spahia - ... çfarë mund të themi kur Kryeministri shqiptar u përgjigjet qytetarëve të vet me një frymë rrugaçërore, të padëgjuar më parë, të pahijshme, qoftë edhe për një zyrtar në zyrën më të fundit të shtetit shqiptar?

Edhe një herë po theksoj se këto janë problemet që shqetësojnë me të vërtetë elektoratin shqiptar, se për dhunën në familje mund të diskutojmë ditë e natë, mund të japim shembuj të dhunës në familje, duke marrë për shembull Kryeministrin shqiptar, i cili është simbol i dhunës ndaj grave, i dhunës në familje, por ju nuk e përmendni, nuk e pranoni, nuk keni kurajë ta pranoni...

(Diskutime pa mikrofon)

Elisa Spiropali – Po ju lutem, doktor, mbylleni mikrofonin!

Bardh Spahia - Unë e kuptoj se ju nuk e keni kurajën, unë e kuptoj se ju u shërbeni karrigeve tuaja, por qytetarët shqiptarë sot kanë prioritetet të tjera. Ata kanë prioritet shkëputjen e këtij shteti, e kësaj maxhorance nga krimi dhe korrupsioni.

Sigurisht, mënyra e vetme ...

(Diskutime pa mikrofon)

Elisa Spiropali – Po ju lutem, doktor, mbylleni mikrofonin!

Zoti Mima ra në gjumë.

Bardh Spahia – Thojuni shqiptarëve pse nuk po hapen negociatat!

Ju bëj thirrje shqiptarëve ta logjikojnë vetë dhe ta marrin në analizë situatën aktuale dhe të marrin në dorë fatet e veta për largimin një orë e më parë të kësaj qeverie.

Faleminderit!

Klodiana Spahiu – Si sekretare e komisionit, ne ju kërkojmë si maxhorancë që të mbledheni si kryesi komisioni. Nëse ju bini dakord që ne të fillojmë me miratimin nen për nen, ne mund të fillojmë punën e komisionit, nëse jo, atëherë e hedhim në votë, se kush është pro për miratimin nen për nen. Ai që nuk është pro, parlamenti ka disa rregulla, ndaj, ju lutem shumë, ne duhet të zbatojmë rregulloren.

Kemi ardhur sot për të miratuar nen për nen një ligj të rëndësishëm, për të cilin është punuar për më shumë se një vit.

Ju lutem, mos të biem në hulli që nuk na çojnë atje ku duhet, por të realizojmë këtë procedurë. Nëse mundet nënkryetari që të bini dakord, nëse jo, atëherë kalojmë në votim.

Faleminderit!

Elisa Spiropali – Unë i kërkoj ndjesë, së pari publikut, se është krejtësisht e papranueshme që opozita vjen këtu dhe mundohet me forcë, pra hyn në komision, mësyn sallat, vjen ulet në komision, të ftuar e të paftuar, anëtarë komisioni apo joanëtarë, kjo nuk ka rëndësi dhe mundohet të mbajë peng funksionimin normal të këtij komisioni dhe të seancave të parlamentit, të jetës politike, të jetës publike të vendit, integritetin e vendit dhe progresi i Shqipërisë. Nuk ka ndodhur ndonjëherë që një opozitë të jetë bërë, të jetë bërë, po e them edhe një herë, vrasësja e shpresës së çdo njeriu që jeton këtu. Me fjalët tuaja, çdo ditë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, se të dëgjova!

Me falët tuaja, me veprimet tuaja, me aktet tuaja të panjohura në asnjë manual veprimi të opozitës, ju po i fusni Shqipërisë çdo ditë thikën pas shpine.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani jemi tri ditë përpara çeljes së negociatave me Bashkimin Europian. Është e nevojshme të kemi një konsensus politik. Është e nevojshme, së pari, të kemi logjikë. Është e papranueshme që e merrni fjalën me dhunë, për procedurë, dhe pastaj vazhdoni e flisni për çfarë t'ju teket juve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bardh Spahia – Kush e mori me dhunë Elisa? Nuk e jep ti fjalën, por Rregullorja e Kuvendit.

Elisa Spiropali – Sot diskutohet projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin për dhunën në familje”, dhe për këtë do të diskutojmë.

Bie dakord me zonjën Spahiu. Do ta hedhim në votë. Atëherë kush mendon se ne duhet të vazhdojmë procedurën normale të votimit të projektligjit nën për nen.

Bardh Spahia – Jo, moj Elisa, nuk bëhet. Ku e ke gjetur këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Orjola Pampuri – Të lutem zonjë, për procedurë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, për procedurë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ti po shkel të drejtën e secilit prej nesh.

Elisa Spiropali – Atëherë, vazhdojmë me diskutimet.

Orjola Pampuri – Të lutem, dua fjalën për procedurë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elisa Spiropali – Zonja Pampuri, e dëgjuam zotërin Spahia. Nuk besoj se do të thoni ndonjë gjë më të mençur nga sa tha zoti Spahia.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Orjola Pampuri – Të lutem, a ka mundësi të flas?

Elisa Spiropali – Edhe një herë: zonja Pampuri, e morët për procedurë; ju lutem respektoni faktin që e keni marrë për procedurë dhe flisni për procedurë.

Orjola Pampuri – Tani, ka mundësi të vazhdoj?

Elisa Spiropali – Patjetër. Për procedurë.

Orjola Pampuri – Mos i paragjyko ato që do të them.

Elisa Spiropali – Për procedurë.

Orjola Pampuri – Pikërisht pra, ju nuk e dini çfarë do të them, kështu që dëgjojeni, e pastaj thoni për çfarë po flas apo duhet të flas.

Atëherë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, Edlira, tani e mora fjalën! Edlira, të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem Edlira, ti je edhe zonjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, Bardhi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, zot jemi mbledhur për një çështje shumë të rëndësishme, siç është dhuna në familje. Dhuna në familje është një ndër çështjet që na ka prekur fort muajt e fundit e vitet e fundit. Rreth 1000 raste të dhunës në familje janë vetëm në vitin 2017.

Elisa Spiropali – Do të keni kohën e diskutimeve. Zonja Pampuri, të lutem, a mund ta respektoni këtë komision?

Orjola Pampuri – Tani, më lërë, Elisa, se po flas tani, se është profesioni im. A mund të vazhdoj tani?

Elisa Spiropali – Nuk është procedurë kjo, zonjë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Orjola Pampuri – Më lërë tani ta përfundoj, të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë kjo është shkelje e të drejtave të secilit prej nesh këtu.

Elisa Spiropali – Ju munguat në mbledhje, kur u diskutua në parim.

Orjola Pampuri – Se kur mungojmë ne, është punë për ne. tani më lërë të mbaroj. Të lutem!

Elisa Spiropali – Është diskutimi nen për nen.

Orjola Pampuri – Kjo është mungesë kulture.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem!

Atëherë, po e përsëris: dhjetë gra janë vrarë vetëm në vitin 2017 nga burrat e tyre.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edlira, të lutem tani!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem tani!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, a ka mundësi të vazhdoj?

Të lutem tani! Mos më trego se për çfarë është takimi!

Elisa Spiropali – Zonja Pampuri, e kemi bërë mbledhjen dëgjimore.

Orjola Pampuri – A ka mundësi të vazhdoj?

Kemi raste të shtuara të dhunës në familje. Njëqind raste të grave...

Elisa Spiropali – E kemi bërë mbledhjen në parim dhe dëgjesën e grupeve. Kjo është nen për nen.

Orjola Pampuri – A ka mundësi? Atëherë, sot kemi një projektligj, i cili pret të miratohet. Projektligjit i janë shtuar disa pika, të cilat, sigurisht, mua më duken interesante, por do të doja të shtoja edhe diçka tjetër: së pari, ne duhet të diskutojmë kauzën, sepse tashmë kjo çështje është shndërruar në një kauzë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edlira, a ka mundësi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edlira, je zonjë, nuk të takon të ndërpresësh fjalën e një zonje tjetër. Të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kemi të bëjmë me dhunën në familje. ne po diskutojmë çështje të rëndësishme dhe po i kapim të gjitha me radhë, nga urdhri i mbrojtjes, zyra e mbrojtjes ligjore, zyra e këshillimit ligjor e të tjera.

Ajo që dua të shtoj është çështje tjetër. Ne duhet ta kapim nga pika zero, që është: nga se vjen gjithë kjo dhunë në familje?

Jemi një vend me popullsi shumë të vogël, por me një numër të jashtëzakonshëm të dhunës së shtuar vitet e fundit në familje, që bazën e ka te kriza ekonomike, bazën e ka te modeli që po ofrohet në këtë vend. Cili është modeli që ofrohet në këtë vend? Ne para dy muajsh kishim disa prioritete për të përmbushur për hapjen e negociatave dhe një nga këto prioritete është ajo për të drejtat e njeriut. Dhuna ndaj gruas është shkelje e të drejtave të njeriut dhe një nga prioritetet është i paplotësuar ashtu sikurse janë edhe të tjerat. Pra, dhuna në familje, dhuna ndaj gruas janë shkelje e të drejtave të njeriut dhe është një nga prioritetet bazë që duhej të plotësonim për hapjen e negociatave.

Elisa Spiropali – Po t'i kishit prioritet, do të kishit ardhur nëpër mbledhje ku diskutohej në parim me grupet e interesit.

Orjola Pampuri – Nga buron e gjitha kjo? Nga një komunikim i tmerrshëm që buron që nga Kryeministri juaj.

Elisa Spiropali – Ishit duke bërë këtë teatër te Komisioni i Ligjeve. Si t'ia bëjmë ne se ju po luani teatër.

Orjola Pampuri – Kryeministri, në një tur llogaridhëniesh, ku del me ju bashkë, duke e shoqëruar, komunikon në mënyrën më të dhunshme me qytetarët e tij, i fton në llogaridhënie dhe, në momentin që ata nuk i binden dhe nuk thonë atë që do ai, atëherë ai i dhunon duke i ofenduar në mënyrën më të turpshme që mund të shajë një kryeministër.

Klodiana Spahiu – Tani jemi në procedurë votimi. Si ka mundësi? Çfarë do të thotë kjo? A e kuptoni çfarë po bëni?

Orjola Pampuri – Po flasim për dhunën dhe ju e shkelni atë me qetësi. Të flasësh me qetësi për dhunën ndërkohë që kemi një ish-ministër të përfshirë në afëra droge, keni një ministër të Brendshëm, i cili merret me drogë, kur ka para të pista që hynë dje, kjo është kriza.

Elisa Spiropali – Vazhdojmë nen për nen, se këtë muhabet keni ju! Zonja Pampuri, nuk ju shkon të bëni këtë bisedë këtu.

Orjola Pampuri – Ju merreni me drogëN, kurse qytetarët varfërohen dhe bazën e ka te kriza ekonomike. Varfëria dhe kriza ekonomike janë baza për të nxitur dhunën në familje.

Elisa Spiropali – Zonja Pampuri, nuk e fitoni dot zemrën e PD-së duke folur këtu për drogë.

Orjola Pampuri – Jo, unë kam profesionin tim, e kam thënë edhe më parë, që baza e dhunës është kriza ekonomike. Ju e keni rrënuar këtë popull dhe kjo është arsyeja pse kemi kaq shumë raste të dhunës në familje.

Elisa Spiropali – Ju jeni dhe konservatore, zonja Pampuri.

Orjola Pampuri – Absolutisht që pjesë e konservatorizmit është edhe kjo. Ju e keni copëtuar familjen, keni përzënë qytetarët.

Elisa Spiropali – O zonjë, po flisnim për procedurë.

Klodiana Spahiu – Zonja kryetare, ju lutem, edhe një herë, jemi në proces votimi. Nëse do të zbatoni Rregulloren e Kuvendit, ju lutem filloni procesin e votimit!

Kemi bërë tri seanca dëgjimore. Nëse opozita ka amendamente, le t'i dorëzojë të enjten 24 orë para votimit.

Elisa Spiropali – Zonja Pampuri, a përfunduat? Ju shkelët çdo besim.

Orjola Pampuri – Besimin e kujt? Ju keni shkelur besimin e qytetarëve. Si mund të dilni ju këtu...

Elisa Spiropali – Ju e morët fjalën për procedurë.

Orjola Pampuri – Kush je ti që më tregon mua besimin? Kjo është dhuna në familje, të heqësh mjekë nga puna, të varfëroni njerëz...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Të nderuar kolegë të opozitës, keni të drejtë të dorëzoni amendamentet 48 orë para miratimit të projektligjit.

Orjola Pampuri – Kriza ekonomike është baza e dhunës në familje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë e filloj nga morali i vetës, përderisa kam moral, përfaqësoj qytetarët dhe dal e flas hapur.

Elisa Spiropali – Të lutem, zonja Pampuri!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Pendavinji – Ne diskutojmë nen për nen, si do të diskutojmë nen për nen me grupet e interesit dhe me anëtarët...

Orjola Pampuri – Çfarë të diskutosh, kur ju e keni dhunuar dhe copëtuar fare shoqërinë?

Ilir Pendavinji – Ti nuk e ke lexuar asnjëherë këtë ligj, nuk vihet këtu për të bërë kakofoni, por për të diskutuar një nga ligjet më të rëndësishme.

Orjola Pampuri – E para që e ka lexuar jam unë dhe ti e di shumë mirë që baza e dhunës është atje ku them unë, te droga dhe ekonomia. Ti je pro drogës dhe pro varfërisë së qytetarëve.

Ilir Pendavinji – Jo, nuk jam pro, përkundrazi, vij këtu që t'i bëjmë këto ligje, që të kemi mundësi t'i rregullojmë.

Orjola Pampuri – Ja ku e ke ministrin tënd të Brendshëm dhe ish-ministrin e Brendshëm. Është turp, se kemi të gjithë moral dhe nuk mund të përfaqësohemi me njerëz të pamoralshëm.

Elisa Spiropali – Zoti Pendavinji, a ka mundësi?

Orjola Pampuri – Ja pra Kryeministri juaj që shan me llafë me....

Elisa Spiropali – Zonja Pampuri...

Orjola Pampuri – Është turp, sepse jeni edhe mjek, ndaj nuk mund të flisni kështu.

(Diskutime pa mikrofon.)

Të gjithë ju heshtni, sepse e dini që jeni në faj.

Elisa Spiropali – Zonja Pampuri, e përfunduat fjalën?

Orjola Pampuri – Për çfarë urdhrash mbrojtjeje do të flisni?! Ku është Firdes Hafizi?! Iku Firdes Hafizi dhe çështja mbeti 10 muaj pa u gjykuar nga gjykatat tuaja, nga vetingu juaj.

Elisa Spiropali – Turpi është juaji. Ja ku janë kamerat, kështu që vazhdojmë me procedurën e propozuar nga sekretarja e komisionit.

(Diskutime pa mikrofon.)

Zoti Pendavinji...

(Diskutime pa mikrofon.)

Orjola Pampuri - Po çfarë janë këto fjalë?! Doktor, nuk të shkon kjo gjë, se jeni edhe doktor.

Elisa Spiropali - Zonja Pampuri, ju folët.

Orjola Pampuri – Çfarë ligji do të bësh, se ti i ke qytetarët pa bukë?! A doni të bëni ligjin e dhunës? Po nuk pati bukë, dhunë do të ketë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Elisa Spiropali – A ka mundësi të heshtësh, zotëri?

Klodiana Spahiu – Zonja kryetare, kërkoj edhe një herë fjalën për procedurë!

Elisa Spiropali - Zonja Spahiu, keni fjalën për procedurë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Klodiana Spahiu – Ju lutem, kjo është shumë e turpshme për ne, sepse nuk ka ndodhur kurrë një situatë e tillë.

Jemi në një komision parlamentar, të nderuar kolegë të opozitës. Ky projektligj ka kaluar në parim, janë bërë disa seanca dëgjimore, janë dëgjuar grupet e interesit dhe ka ardhur momenti të votohet nen për nen.

Ju lutem, jemi në parlament, nuk jemi në rrugë!

Ju lutem, jemi në votimin nen për nen dhe ka një pikë të Rregullores...

(Diskutime pa mikrofon.)

Të nderuar kolegë, nuk mund të vazhdohet me këtë lloj arrogance, sepse është e kotë, vetëm humbni pikë. Në qoftë se pozita ka amendamente, në bazë të Rregullores së Kuvendit, nëse nuk ka marrë pjesë në shqyrtimin e ligjit nen për nen dhe kur është diskutuar me grupet e interesit,

i dorëzon ato në parlament 48 orë pasi të miratohet ligji. Ju garantoj se me këtë që po bëni vetëm po humbni pikë si opozitë, sepse ligji do të kalojë patjetër, pasi është i domosdoshëm.

Ju lutem, zonja kryetare, me gjithë respektin që kam për opozitën, kërkojmë edhe një herë

...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem “Tayota Yaris-in” diskutojeni në rrugë, jo këtu në Kuvend!

Bardh Spahia – Kur është i lidhur kryetari i grupit tuaj parlamentar, bisedohet këtu.

Klodiana Spahiu – Ne, si maxhorancë, kërkojmë edhe një herë të kalojmë në miratimin nen për nen.

Elisa Spiropali - Faleminderit!

Vazhdojmë me votimin nen për nen të projektligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

Bardh Spahia – Kërkojmë fjalën për të bërë diskutime.

Elisa Spiropali - Nuk është seancë diskutimesh, por jemi në diskutimet nen për nen të projektligjit.

Bardh Spahia – E kërkuam fjalën kolegët dhe duhet t’ua japësh.

Elisa Spiropali – Do ta marrin fjalën te neni përkatës, nëse do të kenë amendamente dhe ndryshime për të bërë.

Klevis Balliu – Zonja kryetare, a keni mundësi të na jepni fjalën për procedurë?

Elisa Spiropali – Jo, sepse keni shembullin e zonjës Pampuri.

Vazhdojmë me nenin 1.

Klevis Balliu – Zonja kryetare, a keni mundësi të na jepni fjalën, ose thoni që nuk doni, dhe të biem dakord.

(Diskutime pa mikrofon)

Zonja kryetare, nëse nuk doni të na jepni fjalën, na thoni dhe ne nuk ua kërkojmë më.

Elisa Spiropali – Në pikën 2 të nenit 2 të projektligjit propozojmë të ndryshohet togfjalëshi “autori i veprës penale” dhe të zëvendësohet me termin “dhunues”. A jeni dakord?

Klevis Balliu – Zonja kryetare, ju lutem, nëse nuk doni t’ia jepni fjalën opozitës për procedurë, na tregoni, që ta dimë edhe ne, sepse këto lojërat nen për nen...

Zonja foli shumë qartë për procedurë, kështu që edhe ne kemi disa diskutime për procedurë. Pse u jepni fjalën kolegeve të maxhorancës dhe jo të opozitës?

Elisa Spiropali – Në nenin 2 propozojmë që germa “b” të ndryshojë si më poshtë vijon:
“Vëllezërit, motrat, përfshirë bashkëshortin/en ose bashkëjetuesin/en”

A jeni dakord?

Klevis Balliu – Zonja kryetare, ju ia dhatë fjalën maxhorancës për procedurë, pse nuk ia jepni edhe opozitës ? A ia dhatë fjalën zonjës aty, na e jepni edhe ne fjalën për procedurë! Pse nuk i thoni ju? Sa mirë e ngritët diskutimin për procedurë për veten tuaj!

Bardh Spahia - Elisa, jepi fjalën! Pse nuk ia jep?

Elisa Spiropali – ... “Personit që ndodhet nën kujdesin e tij gjatë kohës që vepron kujdestaria...”

(Diskutime pa mikrofon)

Bardh Spahia – Po merre tani fjalën...

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, thuaja tani, pse duhet t’ia thuash pastaj, e ke aty afër...

Elisa Spiropali - .. sipas përcaktimeve të kujdestarisë mbi të miturit...

Ervin Salianji – Në qoftë se ju do të bëni nga këto lojëra, edhe ne mund të bëjmë lojëra të tjera, hajdeni të diskutojmë...

Elisa Spiropali – .. kujdestarisë me pagesë për personat me aftësi...

Ervin Salianji – Nuk po kujtojmë asgjë për qytetarët shqiptarë, sepse ata kanë interes. Na e jep fjalën për procedurë...

Elisa Spiropali – Po të keni komente për ligjin, bëji...

Ervin Salianji – Po, komente për ligjin kam, ja këtu e kam edhe ligjin!

Elisa Spiropali – ... për të vepruar sipas dispozitave të Kodit të Familjes ...

Ervin Salianji – Zonja kryetare, për ligjin dua të diskutoj...

(Diskutime pa mikrofon)

A më thatë për ligjin, për ligjin e kam...

Elisa Spiropali – Atëherë, për nenin 2 me ndryshimet e lexuara...

Ervin Salianji - .. ose do të na e jepni fjalën...

Elisa Spiropali - ... a ka komente?

Ervin Salianji - Ju na pyesni se kush e do fjalën për procedurë, apo për ju procedura dhe fjala shkon vetëm për kolegët e maxhorancës?

(Diskutime pa mikrofon)

Elisa Spiropali – A ka ministria komente për ...

Ervin Salianji - A ishte momenti se kush e donte fjalën për procedurë?

Sipas jush procedura dhe fjala shkon vetëm për kolegët e maxhorancës...

Elisa Spiropali – A ka komente ministria për nenin 2?

Ervin Salianji – Zonja kryetare, a do të ma e japësh fjalën për procedurë? Nuk morëm vesh asnjë gjë se çfarë u thatë...

Elisa Spiropali - Hedhim në votim nenin 2...

Bardh Spahia – Jepja fjalën kolegut...

(Diskutime pa mikrofon)

Pse nuk na e jepni fjalën?

(Diskutime pa mikrofon)

Ervin Salianji - Arsyeja e vetme pse nuk na e jepni fjalën është se keni frikë nga diskutimet që do të bëhen këtu për drogën, për negociatat. Pse nuk u jepni përgjigje këtyre pyetjeve dhe të kaloni te dhuna në familje?

(Diskutime pa mikrofon)

Për dhunën në familje keni kryetarin tuaj, që është ekspert i dhunës në familje. Shkoni dhe pyeteni dhe jua zbërthen ai të gjithën...

Bardh Spahia – Jepja fjalën kolegut, nëse doni ta mbani mbledhjen në terma normalë...

Ervin Salianji – Elisa, jepja fjalën për procedurë opozitës, ia ke dhënë maxhorancës jepja edhe opozitës.

Elisa Spiropali – A ke amendament?

Urdhëro!

Ervin Salianji – E nderuar drejtuese e komisionit!

Të gjithë jemi deputetë, sepse është një projektligj me rëndësi të veçantë, prandaj ju lutem, krijoni kushtet që secili prej deputetëve dhe qytetarët të dëgjojnë dhe të bëjnë diferencën qoftë edhe për komentet që keni ju mbi komentet e kolegëve deputetë të secilës palë. Këtu nuk është asnjë pronar i kësaj sale dhe disa të tjerë të jenë vartës, por të gjithë këtu jemi kolegë të barabartë...

Elisa Spiropali – A ke amendament?

Ervin Salianji – Të lutem!

Secili duhet të thotë fjalën e tij dhe pastaj atë ta gjykojnë qytetarët.

Ju lutem, mos ndërhyini, nuk ka...

Elisa Spiropali – Të lutem, kemi një rend dite të miratuar në këtë komision, se ju nuk jeni anëtar i këtij komisioni.

Ervin Salianji – Kam një propozim...

Elisa Spiropali – Ju lutem, ju nuk jeni anëtar i këtij komisioni...

Ervin Salianji -Të lutem, unë e di këtë!

Elisa Spiropali – Kemi bërë edhe një votim nen për nen? A mund t'i referoheni kësaj?

Ervin Salianji – Asaj do t'i referohem, por që të vij aty dua që në komision të krijohen kushtet, që të dëgjojnë qytetarët, ndryshe merrni pushim dhe qetësohuni.

Po jua them se ky ligj është i rëndësishëm. Në Shqipëri pa diskutim ka pasoja të mëdha nga dhuna në familje dhe vrasjet, por ne, të gjithë kolegët, po jua themi këto shqetësime, sepse mendojmë se shkaqet nuk janë vetëm prodhimi i ligjeve. Ne i bëjmë ligjet me nxitim, ju e ngrini dorën dhe iku mbaroi. Juve ju duket sikur fituat ndonjë gjë, ne sikur bëmë ndonjë sherr këtu me ju kur kërkojmë fjalën...

(Diskutime pa mikrofon)

Të lutem, ta përfundoj, fjalën ju kemi kërkuar!

Zonjë, të lutem, mos ndërhy se jam duke folur!

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk më provokoni dot...

(Diskutime pa mikrofon)

Bardh Spahiu – Na lini në mënyrën më të mirë të mundshme të flasim, a dëgjoni koleg?

Ervin Salianji – Të lutem, ta përfundoj fjalën dhe pastaj më thoni!

Klodiana Spahiu – Nuk ka sherr, sepse nuk ka për të të lënë njeri të bësh sherr, të jesh i qartë për këtë.

(Diskutime pa mikrofon)

Ervin Salianji - Jam shumë i qartë, sepse për ju kam një dokument nga Italia, por nuk do ta nxjerr sot.

(Diskutime pa mikrofon)

Për ju zonjë, kam një dokument nga Italia, por do ta nxjerr radhën tjetër, familjar dhe për ju personalisht...

Klodiana Spahiu – Mbajti dokumentet...

Ervin Salianji – Më lini ta mbaroj fjalën, të mos merrem edhe me atë që ke hall ti...

Klodiana Spahiu – Është e turpshme...

Ervin Salianji – E di shumë mirë se çfarë halli ke. Unë kam një dokument këtu...

Klodiana Spahiu - Dëgjo, ju jeni...

Ervin Salianji – ... dhe po ju them se për ju shkak nuk janë ligjet, sepse ligje mund të prodhojmë sa të duam ne, por këtu në këtë vend shkak është moszbatimi i ligjit dhe disa njerëz si ju, që tentojnë të na e presin fjalën këtu në komision, a e kupton apo jo?

Klodiana Spahiu – Zonja kryetare, për procedurë!

(Diskutime pa mikrofon)

Klodiana Spahiu - Kjo është dhunë, nuk është fjalë...

Ervin Salianji - Më dëgjoni pak, sepse ju intereson edhe ju...

(Diskutime pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – Mund të të falja çdo gjë, por...

Ervin Salianji – Ky është një vendim i Gjykatës së Apelit, i cili dënon një njeri me 6 muaj burg për shkak të dhunës në familje...

Klodiana Spahiu – Zonja kryetare, të lutem, për procedurë!

Ervin Salianji – Ky vendim i Gjykatës së Apelit...

Klodiana Spahiu – Unë mund të lejoja çdo gjë, por të vijë Salianji këtu dhe të më thotë se ka dokument për mua, e para këtë nuk duhet ta lejoni ju...

Elisa Spiropali – Unë nuk e kam dëgjuar fare...

Ervin Salianji – Ky vendim i Gjykatës së Apelit...

Klodiana Spahiu – Jo...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu -Ju lutem, se nuk ka kuptim!

Elisa Spiropali - Zonja Spahiu.

Ervin Salianji - Unë po them që kam propozim për projektligjin. Kam hyrë nen për nen. Mos më ndërhyini, se unë nuk i kam ndërhyrë askujt!

Elisa Spiropali – Hyni tani, ju lutem!

Ervin Salianji- Ky vendimi këtu dënon një person me 6 muaj burg. Ja ku është ligji, ja ku është edhe zbatimi i ligjit, ja ku është vendimi i gjykatës. Në emër të Republikës, i pandehuri është Edi Lika. Nëse nuk ju thotë gjë se kush është Edi Lika, është personi që u kap dje me 4.5

ose 1.5 ose 5 milionë euro me “Toyota Yaris” në portin e Durrësit. Është vendim gjykatë që e dënon personin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky zotëria që është dënuar, nuk e vuan dënimin. A e dini pse? Sepse ky zotëria bashkë me çunin e vet, që është edhe ky i shoqëruar, Klevi Cani, thotë policia është me ne. Shikojeni pak në Facebook. Ky zotëria thotë: “Policia është me ne”.

Policia është me këta, ne bëjmë sikur prodhojmë ligje, ai dënohet në gjykatë, kapet edhe me 5 milionë euro, se ka lidhje me strukturat e shtetit, të policisë dhe të drejtuesve tuaj të ministrisë. Shikojeni pak, policia e ka kapur vetëm për një arsye, që të mos shkojë hetimi deri në fund dhe të mos zbulohet kreu i grupit të strukturuar kriminal.

Elisa Spiropali – A përfunduat tani, ju lutem? Ndërhyrje në ligj unë nuk pashë nga kjo, pashë vetëm avazin tuaj të zakonshëm që policinë, drejtësinë gjirizet e krimit, SHISH-in, Interpolin të gjitha i keni ju dhe informacione keni ju, por shkoni në prokurori dhe dëshmoni për informacionin që keni dhe mos iu drejto kolegëve që ke këtu në komision sikur ke ti dosjet e njerëzve. Çfarë dosjesh ke ti, zotëri? Kush je ti që iu ke njerëzve dosjet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ervin Salianji – Mos më ndërhyini, se nuk është çështja kush është i fortë!

Elisa Spiropali - Ju të Gardës...Unë jam një grua këtu. Mos prek mikrofonin! Ju lutem, mos m’u afroni!

Ervin Salianji – Nuk është çështje force kjo punë, është çështje fjale.

Elisa Spiropali – Dilni përjashta, mos prekni mikrofonin!

Edhe një herë, ju lutem, Ervin.

Ervin Salianji – Ju lutem, mos më ndërprisni se nuk të marr leje as ty, askujt tjetër.

Elisa Spiropali – A mund të ndërhysh, se po hyn në hapësirën time? Ju lutem, mos prekni mikrofonin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ervin Salianji – I drejtohem qytetarëve në rrëmujë.

Elisa Spiropali - Mos prek mikrofonin!

Ervin Salianji - Ja ku është personi i kapur me “Toyota Yaris” i dënuar për dhunën në familje, ne po bëjmë teatër këtu sikur po miratojmë ligje, ndërkohë që dy ministrat njeri pas tjetrit

janë të lidhur me krimin, ndërkohë sekretarin tuaj të Përgjithshëm të lidhur me krimin, ja ku e keni situatën. Pse shqetësoheni ju për këtë? Unë po nxjerr një dokument.

Elisa Spiropali - Shkoni në prokurori, zotëri!

Ervin Salianji – Po kjo nuk është për prokurori, sepse ky e ka marrë dënimin dhe nuk respektohet ligji. Çfarë do të bëjmë ne tani? A doni ta miratojmë ne tani? Po ngrijeni dorën ju dhe përfundon filmi. Mbarojeni atëherë, mos diskutoni kot! Po ne diskutojmë, qytetarët... ju do të vendosni, ju keni një mendim...

Elisa Spiropali- Ju lutem, shkoni në prokurori.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ervin Salianji- Po nuk është çështje prokurorie kjo.

Elisa Spiropali - Zoti Salianji, mos bëni si pronar i dosjeve këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ka një procedurë kjo këtu. E mori për procedurë. Ka një Rregullore.

Ervin Salianji – Ju doni rrëmujë dhe sherr, ne duam të dëgjojnë qytetarët.

Klodiana Spahiu- Zonja Elisa, a ka mundësi për procedurë?

Elisa Spiropali – Përfundojeni, zoti Salianji, se e ka zonja Spahiu!

Ervin Salianji – Ja ta përfundoj unë se ka ndërhyrë. Ne kemi disa objeksione, qëndrime dhe mendime të ndryshme me ju. Ju keni propozuar projektligjin që po e miratoni. Ju do të miratoni projektligjin, qytetarët do të dëgjojnë edhe mendimin tonë. Kjo është demokracia. Pse shqetësoheni ju për këtë?

Elisa Spiropali- Faleminderit!

Ervin Salianji -Me nder qofsh, po unë nuk kam përfunduar. Nuk është çështje force kjo punë. Mos ndërhyini në fjalën e kolegëve!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Spahiu– A ka mundësi për procedurë?

Ervin Salianji- Jo, procedurë nuk ka nëse kalohet nen për nen. Ky komision nuk mund të jetë si në pazar.

Elisa Spiropali - Po ju e morët fjalën për procedurë.

Ervin Salianji- Nëse e keni kaluar nen për nen, edhe sekretarja e komisionit, edhe Perëndia nuk jua jep dot fjalën, sepse ka rregulla këtu. Unë e kam marrë për të bërë propozim për ligjin.

Elisa Spiropali – A mbaruat tani?

Ervin Salianji – Jo nuk e përfundova.

Elisa Spiropali - Shumë mirë mbylle tani se asnjë amendim nuk pashë.

Ervin Salianji- Jo nuk e kam përfunduar. Kam amendim për projektligjin. Secili mund të ketë amendim. Ju s'mund të silleni në komision sikur jeni pronarë, se nuk ka sens dhe nuk e bëni dot!

Elisa Spiropali – Ju nuk propozuat asnjë amendim! Bëtë të njëjtën gjë që bëni vazhdimisht.

Ervin Salianji - Më lini të mbaroj!

Ju tregova një vendim gjykate për “Toyota Yaris” e keni nxjerrë për ta përdorur për para dhe nuk është në burg për shkak të dhunës në familje. Ja ku e keni!

Elisa Spiropali – Më vjen keq që po jua them, po as ju nuk e fitoni dot zemrën e Partisë Demokratike duke u futur në gjirizet e krimit. Kaq! Fitojeni ndryshe.

Mirupafshim!

Ervin Salianji – Ja ku e keni personin e arrestuar që thotë: “Policia është me ne!”. E kuptoni apo jo? Në vend që të ishte në burg për shkak të dhunës në familje, ky zotëria është në komisarariat i kapur për shkak të partnerëve. Ja ku i keni!

Gjykata e ka dhënë vendimin, zonjë! Nuk e respekton Policia e Shtetit, sepse i merrni njerëzit dhe i përdorni “mish për top”, i përdorni për drogë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Amendimin e bëjmë me qetësi! Vendors rregull në komision dhe, kur ta bësh këtë, atëherë do të jap propozimin.

Elisa Spiropali – Mbylle mikrofonin!

Ky projektligj do të kalojë, me apo pa ju; Shqipëria do të bëhet me apo pa ju; integrimi do të ndodhë me apo pa ju; ju do të bëheni gjithnjë e më të vegjël!

Vazhdo zonja...

Ervin Salianji – Nuk vazhdon dot zonja pa mbaruar unë!

Siguro qetësi që të propozoj amendimin!

Elisa Spiropali – Ju jeni zhurma më e madhe në këtë sallë! Qetësohuni ju dhe këtu do të ketë qetësi!

Ervin Salianji– Rregullo mënyrën se si më drejtohesha, duke filluar nga ti e para..

Elisa Spiropali – Ervin...

Ervin Salianji – Jo, Ervin, se nuk jam shoku yt!

Elisa Spiropali – E di unë shok i kujt je ti, po nuk është vendi i duhur për ta diskutuar!

Ervin Salianji - Mos m'u drejto personalisht, por zgjidh drejtimin e komisionit!

Nuk bën dot të fortin askush këtu!

Elisa Spiropali – Unë ju dhashë fjalën, apo jo, edhe në kundërshtim me votën e maxhorancës. Kërkove fjalën për procedurë..

Ervin Salianji- Nuk është se ajo me PS-në, dhe ne jemi me PD-në. Nuk ka kështu diskutimesh këtu. Jemi deputetë të parlamentit.

Nuk ma dhe ti fjalën, ma jep ligji dhe Kushtetuta!

Siguro qetësinë si drejtuese e seancës, ose merr 5 minuta pushim për t'u qetësuar dhe unë do të bëj propozimin.

Ka ndërhyrë zonja aty 4-5 herë, kanë ndërhyrë edhe drejtues të tjerë. Jua thashë në nisje, ju lutem, respektoni fjalën e gjithsecilit! Askush prej nesh nuk i ka ndërhyrë askujt kur flet. Merreni fjalën, flisni, ne ju dëgjojmë, pavarësisht nëse e meritoni apo jo!

Elisa Spiropali – Ju e keni fjalën, nuk ka nevojë për moral.

Keni një amendament, siç thatë?

Dakord, propozojeni!

Ervin Salianji – Do të vijë.

Elisa Spiropali – Jo do të vijë, thojeni menjëherë! Jemi në diskutimin nen për nen, jo te diskutimet. Ke një amendament për nenin 2, apo jo?

Ervin Salianji - Ja vendimi i gjykatës, ja edhe policia është me ne!

Për çfarë i bëjmë ligjet ne, po të mos i themi këto?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është çështje e diskutimit!

A mund të flasim me qetësi tani?

“Rrezikshmëria e veprës penale e dhunës në familje, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, për të cilën ligjvënësi ka parashikuar dënim me burgim nga 1 deri në 5 vjet, rrezikshmërinë e autorit, pasi nuk ka qenë i dënuar më parë, por veprën e ka kryer ndaj fëmijës së mitur dhe gruas dhe si e tillë, kjo veprë është shoqërisht e rrezikshme dhe duhet mbrojtje e veçantë për këtë kategori të dëmtuarish”.

Fakti se i pandehuri është hetuar dhe gjykuar në gjendje të lirë...

Elisa Spiropali – Nuk është Kodi Penal! Këtu nuk ka lidhje, ke komision tjetër dhe diskutim tjetër. S'ka lidhje fare!

Ervin Salianji – “I pandehuri i datëlindjes 1977, kryefamiljar dhe me fëmijë, ushtron dhunë, ndiqet në gjendje të lirë...”

Elisa Spiropali – Ke ngatërruar Kodin dhe projektligjin sot!

Ervin Salianji – Dhe ju krijoni mekanizma kot! Për çfarë duhen këto? Për t'i pasur në letër?

Unë po them vendimin e gjykatës, dhe ky person është në burg. Në vend që të ishte në burg për dhunën në familje, e keni përdorur për drogë. Çfarë shqetësimi keni ju këtu? Çfarë ligjesh të propozojmë ne, kur nuk pranoni që të themi se shkaqet e kësaj situate të dhunës në familje janë varfëria, gjendja e kriminalitetit, është droga e përhapur në çdo cep në shkolla, qytete, lagje e fshatra. Aktiviteti më i rëndësishëm ekonomik në këtë vend është kthyer droga. Dhe pse ka ndodhur kjo? Ka ndodhur sepse ky është modeli që ndërtoni ju! Njëri ministër gati në burg me 20 vjet për grup të strukturuar kriminal, tjetri përdor gjithë fuqinë politike që ka për të shpëtuar veten nga hetimi dhe vëllain e vet.

Elisa Spiropali – Po ju lë të flisni, sepse **sa** më shumë të flisni, aq më shumë ju dëgjojnë ata aty...

Ervin Salianji – Shumë mirë po bëni. E keni kuptuar se nuk na ndaloni dot!

Elisa Spiropali – ...dhe ju vazhdoni rrënimin!

Dakord.

Ervin Salianji – Pra, kjo është situata. Tani, qytetarët e ndajnë vetë nëse kemi të drejtë ne, që ky zotëria, Edi Lika, ku i dënuar është me burg...

Elisa Spiropali – Zoti Salianji, kishe propozim, apo jo?

Ervin Salianji – ...për drogë dhe për miliona euro, apo është për dhunë në familje? Kaq. Ky është diskutimi sot këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elisa Spiropali – Çfarë?

Të mos ketë ligj, tha.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, në rregull, vazhdojmë me nenin 2. Ka amendamente të tjera? Nuk ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E diskutuam pra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Votojmë nenin, me ndryshimet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klevis Balliu – Kemi propozim, amendim.

Bardh Spahia – Një sekondë, se ka diskutime për amendim, ka propozime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klevis Balliu – Lëre, ta them unë tani.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, kush jeni ju që flisni këtu?

Pa ju drejtuar njeri, mos...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Qytetare?! Ju nuk keni punë fare!

Elisa Spiropali – Mos iu drejtoni zonjës!

(Debat në sallë)

Klevis Balliu – A ka mundësi...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si e lejon ti atë të më drejtohet mua?!

(Debat në sallë)

Ka rregulla këtu! Është komision parlamentar këtu!

Elisa Spiropali – Të lutem!

Klevis Balliu – I keni bërë këto komisionet...

Elisa Spiropali – Mos iu drejtoni zonjës!

Klevis Balliu – Po të drejtohem ty, se me atë nuk kam punë fare!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elisa Spiropali – Të lutem!

Klevis Balliu – Të drejtohem ty: si e lejon këtë zonjën?

Bardh Spahia – O ti, zonjë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elisa Spiropali – Të lutem, zonja Xhafaj!

Bardh Spahia – Nuk ke ardhur këtu për të treguar se je anëtare e devotshme ose e partisë...

(Deputeti Spahia flet pa mikrofon.)

Elisa Spiropali – Ule zërin!

Klevis Balliu – Zonja kryetare, kam një propozim.

Elisa Spiropali – Vazhdojmë me votimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klevis Balliu – Prit, pra, se nuk vazhdon dot me votimin!

Elisa Spiropali – Vazhdojmë me votimin.

Neni 2.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klevis Balliu – Zonja kryetare...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bravo, shumë mirë!

Elisa Spiropali – Neni 2.

Klevis Balliu – “Bravo Enver Hoxha”! Shumë mirë, ju ka mësuar Enveri të gjithëve...!

Bardh Spahia – Kujdes! Nuk je këtu në mbledhje të Partisë Socialiste. More vesh?

(Deputeti Spahia flet pa mikrofon.)

Klevis Balliu – Zonja Spiropali, të lutem, a ka mundësi?

Elisa Spiropali – Me dhjetë vota, kalon neni 2, me ndryshimet.

Vazhdojmë.

Klevis Balliu – A ka mundësi, të lutem?

Po, po, për nenin 2 kam propozim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elisa Spiropali – Neni 3.

Klevis Balliu – Lidhur me nenin 3...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të gjitha nenet i keni vënë gabim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja kryetare, a mund ta marr fjalën...?

Lindita Metaliaj – Nuk ia mbyllni dot gojën opozitës!

Klevis Balliu – Zonja Spiropali, të lutem, a mund ta marrim fjalën?

Elisa Spiropali – Atëherë, ju lutem...

Lindita Metaliaj – Ju lutem, opozita ka fjalën e lirë, diskutimin dhe debatin!

Elisa Spiropali – Ju lutem, me radhë! Do t'jua jap fjalën unë!

Lindita Metaliaj – Nuk ia mbyllni dot gojën. Të lutem, t'i përfundojmë diskutimet!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elisa Spiropali – Nuk po jua mbyll njeri gojën, po marrim një herë propozimet që kanë ardhur nga ministria. Pastaj, nëse ka amendamente, patjetër, do ta merrni fjalën!

Klevis Balliu – Kemi propozim ne.

Zonja kryetare...

Lindita Metaliaj – Ministria do ta marrë fjalën pasi ta përfundojmë ne!

Klevis Balliu – A ka mundësi, mor, se nuk po shkojmë dot në një komision të mbajmë një fjalë?

Elisa Spiropali – Atëherë, ndryshime...

Klevis Balliu – Shkojmë tek Ulsiu, nuk ta jep fjalën; shkojmë te Braçja, nuk ta jep fjalën! Çfarë jeni bërë ju, mor!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jepni, mor, fjalën këtu tani!

Lindita Metaliaj – Nuk e kuptoj pse keni frikë nga fjala e lirë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë, moj...!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elisa Spiropali – Neni 3...

Klevis Balliu – Zonja kryetare, të lutem shumë, a ka mundësi të na japësh fjalën?

(Debat në sallë)

Elisa Spiropali – A mund ta lexoj nenin 3? Pastaj vazhdoni.

Klevis Balliu – Zonja kryetare...!

Elisa Spiropali – Atëherë, lidhur me nenin 3/1, ka një propozim për ndryshim...

Klevis Balliu – Nuk do të vazhdoni me asnjë nen këtu pa marrë fjalën opozita! E keni kot sikur t'i bini gjithë ditën vërdallë këtij komisioni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elisa Spiropali – “Legjislacioni i zbatueshëm”...

Klevis Balliu – Do të marrë një herë fjalën opozita dhe pastaj do të diskutohet!

Elisa Spiropali – Ky ligj zbatohet në parimet e sanksionuara...

Klevis Balliu – Zonja kryetare, jepini fjalën opozitës!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elisa Spiropali – ... në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe në konventat dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

Klevis Balliu - Jepini fjalën opozitës, zonja kryetare!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A e kuptoni se ku keni arritur? A e kuptoni se në çfarë pike keni degraduar, apo jo?

Zonja kryetare,

Elisa Spiropali – Pushim, deri sa garda t’ju nxjerrë jashtë.

Klevis Balliu - Asnjëri nuk ka për të dalë jashtë! Nëse ka njeri për të dalë jashtë, do të dalin jashtë këta këtu që nuk na japin fjalën dhe kjo zonja që flet me gjithë miletin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Asnjëri nuk do të dalë jashtë! Nëse do të dalin jashtë të dalin të gjithë të tjerët.

Jepini fjalën opozitës!

I hoqi edhe dritat, edhe të gjitha.

Na jepni fjalën, zonja kryetare, se nuk është normale kjo!

Elisa Spiropali – Mediet le të rrinë për të dëshmuar shëmtinë e tyre deri në fund.

Klevis Balliu - Më jep fjalën, se na habitët!

Nuk ka gjë më të thjeshtë. Po kërkoj fjalën për të bërë një diskutim.

Elisa Spiropali – 5 minuta pushim deri sa këta këtu, deri sa ky njeri të dalë jashtë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klevis Balliu - Po ku e di ti, se çfarë do të diskutoj unë, zonjë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elisa Spiropali – Si guxon?

Klevis Balliu - Ju doni ta kaloni në votim si Enver Hoxha. Kundër nuk ka, abstenim nuk ka, ligji miratohet.

Bravo ju qoftë! Miratojeni! Kështu nuk ju pengon njeri! Vazhdoni! E keni marrë maxhorancën, e fituat! E gëzofshi! Por 600 mijë shqiptarë kanë ikur.

Ky tjetri thotë se nuk është futur në burg, ju thoni se e ka fajin opozita.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk e kam për televizor, unë i them gjërat ashtu siç i mendoj, zonjë. Unë nuk vi me misione politike këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonjë, unë i them gjërat ashtu siç i mendoj. Unë nuk e kam hallin a më regjistrojnë kamerat apo jo. Unë po ju tregoj edhe juve që të flisni për këtë drogë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta mbaroj!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk është ashtu radha e punës. Kur kërkohet fjala për procedurë, merret menjëherë fjala.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mësojeni këtë, zonjë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duhet t'i mësosh rregullat!

Më vjen keq?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ti nuk i di se po flet gabim. Unë kam propozim për amendamente. Çfarë ke ti?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë kam një propozim

(Ndërpritet mbledhja)

(Rifillon mbledhja)

Elisa Spiropali – Së pari, i kërkoj ndjesë të gjithë opinionit publik për atë çka panë sot këtu, në këtë komision, dhe ju garantoj që nga maxhoranca, do të kenë gjithmonë vëmendjen e duhur përgjegjshmërinë për të diskutuar këtu në komision, për ligje, po ashtu edhe në seancë! Duke qenë se situata është e jashtëzakonshme, është e pamundur të procedohet për të lexuar nenet dhe...

Bardh Spahia – Kërkojini ndjesë për moshapjen e negociatave dhe për makinat me paratë e drogës që vazhdojnë të kapen në kufijtë tanë.

Elisa Spiropali – Të lutem, ta mbaroj dhe më pas vazhdoni. Duke qenë se është e pamundur ta vazhdojmë këtë mbledhje këtu, e kemi fizikisht të pamundur...

Bardh Spahia – Për këtë kërkojini ndjesë opinionit publik.

Elisa Spiropali - ...sepse këtu i mbyllet mikrofoni kryetarit, nuk lihen kolegët të flasin, gati-gati është një situatë fizike, të cilën nuk e përballojmë dot. Ne këtu kemi ardhur të flasim me fjalë dhe me logjikë...

Klevis Balliu – Zonja kryetare, a mund të na i jepni fjalën?! Mos zgjidhni bojkotin, se bojkoti nuk i shërben parlamentarizmit.

Bardh Spahia – Ju nuk përballoni dot fjalën dhe të vërtetat.

Elisa Spiropali – Kjo seancë e këtij komisioni mbyllet dhe do të lajmëroheni për një orë tjetër për diskutimin e këtij projektligji kaq të rëndësishëm.

Bardh Spahia – Jepjani fjalën opozitës.

Elisa Spiropali – Faleminderit!

Bardh Spahia – Mos i mbyllni gojën opozitës!

Elisa Spiropali – Zoti Bardhi, të dalë jashtë.

Klevis Balliu – Mos zgjidhni bojkotin.

(Ndërpritet mbledhja)

(Rifillon mbledhja në orën 13.00)

Elisa Spiropali – Edhe një herë, i kërkoj ndjesë publikut për zhurmën e panevojshme në mbledhjen e paradites, e shkaktuar nga një opozitë, e cila nuk ka as kokë, as fillim, as mbarim, as ide, as vizion dhe asnjë perspektivë, por ka vetëm zhurmën, vetëm shantazhin dhe vetëm dhunën si mjet për të çuar përpara idetë e saj të paqena opozitare.

Vazhdojmë me diskutimin nen për nen të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar””. Nenet 1, 2 dhe 3 u diskutuan në pjesën e parë, kështu që vazhdojmë me nenet në vazhdim.

Neni 3 nuk ka ndryshime, pra siç është paraqitur.

E hedhim edhe një herë në votim nenin 3, në rast se ka pasur paqartësi.

10 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Për nenin 5 të projektit, nuk ka ndryshime.

Në pikën 1, germet “c”, “ç” dhe “d” ndryshohen si vijon më poshtë. Në germën “c” ka një ndryshim “bazë të detyrueshme për t’u përmbushur nga shteti”. Besoj se ju e keni si koment?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 4 nuk ka ndryshime. Në rregull, e hedhim në votim nenin 4, pastaj vazhdojmë me nenin 5.

Kush është dakord me nenin 4? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5, ndryshimet në germën “c” “bazë e detyrueshme për t’u përmbushur nga shteti”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, ka një propozim. Ky është një propozim i grupit të interesit, CRCA-s: “Të gjitha nevojave është jo shterues si term dhe jo detyruesisht nënkupton detyrimet që ka shteti për të plotësuar një pjesë të tyre, por jo të gjitha”.

A ka koment ministria?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull.

Në germën “ç” kemi një ndryshim, pra është shtuar “për të ofruar trajnime” dhe një koment: në mendimin tonë duhet eliminuar çdo referencë në ligj i emrave të përveçëm për urdhra e të tjera, pasi ligji i jep të drejtë çdo agjencie apo organizate që ka trajnime të akredituar t’i ofrojë ato. Përmendja e të dy urdhrave specifikisht mund të përdoret për të përjashtuar agjenci dhe organizata të tjera. A ka komente për këtë pjesë?

Ardiana Jaku – Ne i qëndrojmë propozimit që kemi dhënë, pra që duhet përfshirë Urdhri i Psikologut dhe Urdhri i Punonjësit Social, për faktin se janë këto institucionet që akreditojnë të gjithë punonjësit, si psikologët, ashtu dhe punonjësit social. Kështu që ne i qëndrojmë variantit që kemi propozuar.

Elisa Spiropali – Në rregull.

Në pikën 9, germa “gj”, ne rekomandojmë që germa “gj” të ndryshohet tërësisht sipas kësaj përmbajtje. A keni ndonjë koment, apo i qëndroni versionit fillestar?

Merita Xhafaj – Ne i qëndrojmë versionit fillestar, pra versionit tonë.

Elisa Spiropali – Në rregull.

Sërish në pikën 3 të nenit 5, në germën “h” shtohet: “si dhe monitorimin zbatimit të tyre”.
Në rregull.

E hedhim në votë nenin 5, siç e propozon ministria.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, në një pikë pranohet propozimi i CRCA-s, të tjerat qëndrojnë siç janë.

Neni 5.

Kush është dakord me nenin 5? 10 pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6.

Për nenin 6 ka një propozim nga Rrjeti i Monitorimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore për të shtuar në pikën 2 propozime në lidhje me nenin 6 të projektit: “me gjithë infrastrukturën e nevojshme në përputhje dhe me parimin e përshtatjes së arsyeshme”. Besoj se e keni këtë ndryshim?

Urdhëroni, zonja Xhafaj!

Merita Xhafaj – Ndryshimin e kemi dhe jemi dakord.

Elisa Spiropali – Në rregull.

Në pikën 6 të nenit 6, sipas germës “ç”, të shtohet një pikë vetme si vijon: “Marrjen e masave për zbatimin e vendimit gjyqësor nga organet vendore të vendbanimit dhe/ose vendqëndrimit të viktimës”.

A jeni dakord me ndryshimin?

Merita Xhafaj – Po.

Elisa Spiropali – Në rregull.

Ndryshime të tjera në këtë nen nuk ka. Atëherë, e hedhim nenin në votim.

Pro? 10 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 7: “Çdo organ apo autoritet ku drejtohet viktimë garanton mbrojtjen sipas këtij ligji, pavarësisht vendndalimit ose vendqëndrimit të viktimës. Kjo mbrojtje nënkupton asistencën për strehim të përkohshëm, transportin drejt një strehimi të sigurt apo drejt shërbimeve të kërkuara, shoqërimin drejt urgjencës apo shërbimeve mjekësore të domosdoshme ose pranë shërbimeve të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje etj.”

A jeni dakord me ndryshimin?

Ardiana Jaku – Jemi dakord me ndryshimin që ka propozuar shoqëria civile.

Elisa Spiropali – E hedhim në votë nenin 7.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ardiana Jaku – Bëhet fjalë për rastet emergjente, pra strehimi në një rast emergjent.

Elisa Spiropali – Dakord.

Atëherë, e hedhim në votë nenin 7? A jeni dakord?

10 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Neni 8: “Në pikën 3 të nenit 8, pas shkronjës “d” shtohet shkronja “dh” me këtë përmbajtje: planin personal të ndërhyrjes, masat dhe shërbimet e nevojshme që duhen marrë për të mbrojtur viktimën nga dhuna në vazhdimësi, ofrimin e shërbimeve të menjëhershme dhe minimizimin e pasojave të dhunës.”

A jeni dakord?

Ardiana Jaku – Në rregull.

Elisa Spiropali – E hedhim në votë nenin 8. A jeni dakord?

10 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Neni 9: “Në nenin 10, pika 1, të shtohet vetëm togfjalëshi si më poshtë vijon: “kujdestarinë me pagesë për personat me aftësi të kufizuara” dhe në pikën 5: “por në asnjë rast nuk mund të japë urdhra të menjëhershëm mbrojtjeje për të dyja palët ndërgjyqëse njëkohësisht ose përgjatë zbatimit të urdhrit””.

Ardiana Jaku – Pranohen këto ndryshime.

Elisa Spiropali – Ndryshim tjetër nuk ka.

E hedhim në votë nenin 9. A jeni dakord?

10 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Neni 10. Atëherë, pika 5, propozime në lidhje me nenin 10 të projektit. Ka një propozim nga Rrjeti i Monitorimit të Dhunës kundër Grave, të cilët sugjerojnë të shtohet fjalia si më poshtë vijon: “Përfaqësuesi i Policisë së Shtetit dhe/ose koordinatori vendor paraqiten në seancën gjyqësore për të dhënë shpjegime. “

A është dakord ministria?

Ardiana Jaku – Dakord.

Elisa Spiropali – E hedhim në votë nenin 10. A jeni dakord?

10 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Neni 11. Propozime në lidhje me nenin 11 të projektit: “Në pikën 4 të nenit 14 të projektit të shtohet vetëm togfjalëshi si vijon: “të interpretim të gjuhës së shenjave”. A jeni dakord?

Ardiana Jaku – Dakord.

Elisa Spiropali – Me sa shoh, nuk ka ndryshim tjetër.

E hedhim në votë nenin 11. A jeni dakord?

10 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Neni 12. Nuk ka ndryshime apo propozime.

E hedhim në votë nenin 12. A jeni dakord?

10 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Neni 13. Nuk ka ndryshime apo propozime.

E hedhim në votë nenin 13. A jeni dakord?

10 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Neni 14. Pro?

10 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Neni 15. Pro?

10 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Neni 16. Pro? 10 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Neni 17. Nuk ka ndryshime të propozuara. E hedhim në votë nenin 17. A jeni dakord?

10 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Neni 18. Pro? 10 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Neni 19. Pro? 10 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Kush është pro?

10 vota pro. Kundër? Asnjë kundër, asnjë abstenim.

Urime!

Miratohet.

Faleminderit për durimin tuaj!

Mirupafshim!

MBYLLET MBLEDHJA